

# Kartela e çdo pacienti me SPOK duhet të ketë:

1. Në kartelën e çdo pacienti duhanpirës ka të dokumentuar sa paketa-vite ka konsumuar *dhe*

2. Në kartelën e çdo pacienti që ka mbi 10 vite-paketë\* ka të dokumentuar që është përfshirë në edukimin motivues mbi lënien e duhanit për parandalimin e zhvillimit të SPOK-ut dhe ka të plotësuar (të përfshirë në kartelë) pyetësorin për depistimin për SPOK (Pyetësori i depistimit për SPOK, Aneks 13.2)

3. Kartela e çdo pacienti me SPOK ka të dokumentuar në faqen kryesore dhe të përditësuar në çdo vizitë të dhënat si më poshtë:

- Alergjitë
- Medikamentet që merr
- Sëmundjet shoqëruese dhe nëse janë apo jo të kontrolluara
- Duhan paketa-vite\*
- Profesioni/Ambienti i punës
- Vaksinimi kundrejt pneumokokut, gripit (përfshirë datën e administrimit)
- Riakutizime, data e episodeve
- Plani i individualizuar i ndjekjes së SPOK-ut
- BMI

**Plani i Individualizuar i Ndjekjes së SPOK-ut**, është një nga mjetet më të rëndësishme në edukimin epacientit për aftësimin e tij në vetëmenaxhimin e SPOK-ut. Hartimi i planit duhet dokumentuar në kartelë në ditën e hartimit dhe t'i jepet pacientit një kopje duke e sqaruar që ta sjellë çdo herë me vete në vizitë ose ta ketë me foto në celularin e tij.

4. Testi i vlerësimit të SPOK-ut (CATtest) dhe ka të dokumentuar të dhënat e përdorimit të tij në përshkrimin e ditës së vizitës përkatëse.

5. Programi i edukimit të pacientit me SPOK, ku dokumentohet data dhe çështjet e edukimit të pacientit dhe në përshkrimin e vizitës së asaj dite thuhet edukimi i pacientit për çështjen përkatëse.

\*Paketë-vite=paketë(a) cigareje të konsumuara në ditë e shumëzuar me vitet e duhanpirjes së rregullt.